

## E MARTA E MADHE. Paravolia e 10 Virgjëreshave



E martë, 11 prill 2023 - Kujtimi i ditës  
JAVA E MADHE E PASHKËS - KRESHMË  
E MARTA E MADHE. Paravolia e 10 Virgjëreshave.

- Paravolia e 10 Virgjëreshave -

Të Martën e Madhe përkujtojmë paravolinë e dhjetë virgjëreshave, të cilën Krishti e tregoi gjatë predikimeve të Tij. Kisha jonë e Shenjtë na fton që të jemi gati që ta presim, duke mbajtur ndezur lambadhat e virtyteve tona, për Dhëndrin Qiellor, për Zotin Krisht, i Cili do të vijë në çastin e vdekjes sonë, por edhe në ardhjen e Tij të dytë. Gjithashtu na fton, duke na rikujtuar paravolinë e talandave, që të vëmë në punë dhuratat dhe hirin që Zoti na ka dhënë.

Paravolia e dhjetë virgjëreshave ka në thelb të saj të na tregojë se ai person, i cili ka një virtyt dhe dhuratë të madhe, por që nuk e vë në shërbim të virtyteve të tjera edhe sidomos të lëmoshës, nuk mund të hyjë bashkë me Krishtin në prehjen e

përjetshme, dhe kthehet mbrapa i turpëruar. Edhe asgjë nuk është aq e dhimbshme dhe e turpshme se sa një virgjëreshë që lufton nga dashuria pas parasë.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)